

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0622-A0001***Paditësi***N T**, fshati B, Viti**Kundër:***E paditura/Ankuese***N.SH. N.B.I. “Agromorava”,** (në likuidim), me përfaqësuese **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6565, të datës 19 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-6565, i datës 19 tetor 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 17 tetor 2014, paditësi kishte parashtruar një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) me nr. GJI035-0173 të datës 8 tetor 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,200.00 euro nga N.SH N.B.I “Agromorava” ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar rezulton se kërkesa e paditësit ishte parashkruar.

Në ankesë theksohej se AKP të gjithë punëtorëve i kishte dërguar njoftimin – lajmërimin së bashku me formularin për aplikim ku i kishte njoftuar se N.SH “Agromorava” nga Vitia është në procedurë të likuidimit dhe atë që nga 14 korrik 2014 deri më 27 gusht 2014, ku çdo punëtor është dashur të mbush aplikacionin për realizmin e kërkesës. Në bazë të këtij afat i njëjti kishte theksuar se ka mbushur kërkesën-formularin të dërguar nga AKP për pagesën e 7 pagave në shumën prej 1,200.00 euro për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës. Vendimi i lartcekur kishte konsideruar se nuk ka asnjë bazë ligjore sepse në vet njoftimin e AKP-së është thënë se kërkesat do të shqyrtohen dhe realizohen dhe se punëtorët do të paraqesin kërkesat e tyre pasi të filloj procedura e likuidimit. Andaj, duke pasur parasysh këto që u thanë i kishte propozuar gjykatës që t’i njihet e drejta në dëmshpërblim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,200.00 euro bashkë me interes ligjor dhe shpenzime gjyqësore.

Ankesës i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0173 të datës 8 tetor 2014, listën përfundimtare të punëtorëve që i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjesë të 20% prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës, njoftimin e datës 25 nëntor 2005 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, një procesverbal i datës 15 prill 2011 i N.SH “Agromorava”, një konfirmim i Policisë së Kosovës për regjistrimin e rastit “Zjarrëvënie” me nr. 2011-CG-0176 në të cilin rast kishte ardhur deri të djegja e lokale të N.SH “Agromorava” i datës 19 prill 2011.

Me datë 25 korrik 2022, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën kishte theksuar se parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086

i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të Autoritetit të Likuidimit duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin për AKP-në. Tutje, e paditura kishte konsideruar se kërkesa do të duhej të ishte paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Pra, në rastin konkret 3 vite nga qershori i vitit 2008. Andaj, i kishte propozuar gjykatës që të refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit. Mbrojtjes i kishte bashkëngjitur vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0173 të datës 1 tetor 2014.

Me datë 27 korrik 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për të paditurën (AKP) nga e cila kishte kërkuar që në afat prej 7 ditësh të dorëzoj në DHPGJS njoftimin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për ankuesin N T, të sqaroj procedurën e shpërndarjes së njoftimeve për përfundimin e punësimit nga AKP tek punonjësit pasi që në shkresa të lëndës është dorëzuar një njoftim nga ankuesi i datës 25 nëntor 2005 pa emër dhe mbiemër.

Me datë 19 gusht 2022, e paditura duke iu përgjigjur urdhrin të gjykatës kishte sqaruar se N.SH “Agromorava” kishte hyrë në likuidim me 7 korrik 2014. Nga viti 2008 prej kur kishte hyrë në fuqi ligji i AKP-së, me ç ‘rast parashtruesit i kishte lindur e drejta në kompensim e deri në vitin 2011 parashtruesi nuk ka realizuar të drejtën e tij ligjore për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kësaj përgjigje i kishte bashkëngjitur njoftimin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit të datës 25 nëntor 2005 me emër dhe mbiemër të paditësit.

Me datë 19 tetor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-6565 kishte aprovuar si të bazuar ankesën e paditësit, duke ndryshuar kështu vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. GJI035-0173 të datës 8 tetor 2014, ashtu që kishte obliguar të paditurën AKP që ankuesit në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës t’ia paguaj shumën prej 1,200.00 euro si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore t’i paguaj shumën prej 120.00 euro. Gjithashtu kishte obliguar të paditurën që ankuesi t’ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124.00 euro. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohej se ankuesi me njoftimin e tij të datës 25 nëntor 2005 ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të ndërmarrjes dhe se çdo kërkesë eventuale që

mund të ketë ndaj ndërmarrjes duhet ta parashtroj me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit. Futja e N.SH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk varej nga vullneti i ankuesit, andaj ankuesi ka pasur pritje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditore në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit nuk mund t'i atribuohet ankuesit dhe kështu ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditore që mund ti ketë duhet ti parashtroj kur të filloj procedura e likuidimit. E paditura as në vendimin e saj dhe as në mbrojtje në ankesë nuk e kishte kontestuar ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe as lartësinë e pagesës për dëmshpërblimin e ankuesit prandaj nuk ka nevojë të provohet më tepër. Prandaj, duke u bazuar në këto arsye shkalla e parë kishte konsideruar se ankuesi ka arritur të dëshmoj të drejtën e tij në kompensim sipas nenit 40 paragrafi 1.6 pika 1.6.2 e Shtojcës së Ligjit për AKP-në.

Me datë 10 nëntor 2022, AKP-ja (më tutje ankuesja) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-6565 të datës 19 tetor 2022 (më tutje aktgjykimi i ankimuar), duke i propozuar Kolegjtit të Apelit të DHPGJS-së që të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar duke refuzuar ankesën ndaj vendimit të AL si të pabazuar dhe duke vërtetuar vendimin e AL. Në ankesë theksohet se gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe atë dy afatet e parashkrimit të cilat Autoriteti i Likuidimit është i obliguar t'i pranoj dhe përmes të cilave aplikon në mënyrë të drejtë ligjin. Afati i parë ka të bëjë me afatin për parashtrim të kërkesave që është afat për të dorëzuar një dëshmi të kërkesës në procedurën e likuidimit, ndërsa afati i dytë ka të bëjë me natyrën (meritat) e së drejtës të cilën parashtruesi ka kërkuar ta zbatoj në kërkesë. Këto dy afate duhet të përmbushen nga një kreditor në mënyrë që kërkesa e tij të pranohet e nëse një kreditor dështon të përmbushë një prej këtyre afateve, kërkesa e tij do të refuzohet pavarësisht faktit se ai ka përmbushur afatin tjetër. Duke injoruar plotësisht parashtruesin e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje, Aktvendimi nuk përmbushë aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit nr. 06/L-086 për Dhomën e Posacme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtrësive të prezantuara gjatë procedurës. Autoriteti i Likuidimit fton DHPGJS-në që të lëshohet edhe njëherë në shqyrtim të çështjes në fjalë dhe të konsideroj argumentet e Autoritetit të Likuidimit

që kanë të bëjnë me kufizimet e të drejtave të parashtruesve e që këto kufizime Autoriteti i Likuidimit është i obliguar që t'i zbatoj Ex officio. Ankesës i kishte bashkëngjitur Aktgjykimin e ankimuar dhe vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 5 janar 2023, paditësit i ishte dërguar ankesa e AKP-së, mirëpo i njëjti nuk kishte parashtruar përgjigje.

Arsyetimi i ligjor

Ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar shkallës së parë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,200.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për shkak se e njëjta ishte konsideruar nga Autoriteti i Likuidimit si e parashkruar.

Paditësi në ankesën e tij në shkallë të parë të ushtruar kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit, përveç që vazhdon të kërkoj kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, i njëjti i kishte bashkëngjitur edhe këto prova të shkresa të lëndës: listën përfundimtare të punëtorëve që i kanë plotësuar kushtet për marrjen e një pjesë të 20% prej të hyrave nga shitja dhe përvoja e tyre e punës, njoftimin e datës 25 nëntor 2005 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit, një procesverbal i datës 15 prill 2011 i N.SH “Agromorava”, një konfirmim i Policisë së Kosovës për regjistrimin e rastit “Zjarrvënie” me nr. 2011-CG-0176 në të cilin rast kishte ardhur deri të djegja e lokale të N.SH “Agromorava” i datës 19 prill 2011.

Shkalla e parë e DHPGJS-së, pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, kishte nxjerrë Aktgjykim me të cilin i kishte njohur paditësit të drejtën në kompensim në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumën prej 1,200.00 euro me arsyetimin se i njëjti kishte dorëzuar prova relevante që dëshmonin se N.SH në fjalë ka detyrim ndaj paditësit si dhe në emër të interesit ligjor prej 10% shumën prej 120.00 euro.

Kolegji i Apelit në rastin konkret vlerëson se shkalla e parë e DHPGJS kishte vepruar drejtë me rastin e marrjes së vendimit, ndërsa konsideron se ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Kjo për faktin se nga Njoftimi i AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit i datës 25 nëntor 2005, i cili është i bashkëngjitur në prova në shkresa të lëndës, shihet që paditësit i është ndërprerë parashkrimi i kërkesës për kompensim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kur kishte filluar privatizimi i ndërmarrjes në fjalë, pra me 25 nëntor 2005. Ky njoftim në përmbajtjen e tij thekson se *“shumat-pagat që u janë borxh juve sipas kontratës tuaj të punësimit me punëdhënësin, do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit dhe se kërkesat e tilla do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura”*.

Prandaj, paditësi duke vepruar konform njoftimit që i është bërë, ashtu siç theksohet edhe në vendimin e Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit për dorëzimin e kërkesave kishte paraqitur kërkesën për kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ashtu siç ishte njoftuar nga AKM-ja.

Sa i përket pretendimeve të së paditurës në ankesën e saj të paraqitur në shkallë të dytë, Kolegji i Apelit vlerëson se e paditura nuk ka paraqitur asnjë argument me të cilin do të dëshmonte të kundërtën e asaj që ka provuar paditësi, pra për të vërtetuar faktin se paditësit nuk i takon dëmshpërblimi në fjalë dhe gjithashtu nuk e ka kontestuar as shumën e kërkuar nga ana e paditësit.

Prandaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, Kolegji i Apelit konsideron se shkalla e parë ka vepruar drejtë kur paditësit i ka njohur të drejtën në kompensim për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,200.00 euro si dhe interesin ligjor prej 10% në shumën prej 120.00 euro.

Nga arsyet e cekura më lartë, ankesa e të paditurës refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 12 dhjetor 2022, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 prill 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
